



SQ



# *Fëmijët që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare*

Informacioni për fëmijët e pashoqëruar që aplikojnë për mbrojtje ndërkombëtare sipas nenit 4 të rregullores së (BE) nr. 604/2013

Ne ju kemi dhënë këtë fletë-palosje sepse ju keni shprehur nevojën për mbrojtje dhe ju na keni thënë se jeni më pak se 18 vjeç. Nëse ju jeni më pak se 18 vjeç ju konsideroheni si fëmijë. Ju gjithashtu do të dëgjoni autoritetet t'ju referohen ju si një 'i mitur', çka është e njëjta gjë si fëmijë. 'Autoritetet' janë personat përgjegjës për të marrë një vendim për pretendimin tuaj për mbrojtje.

**Nëse ju kërkon mbrojtje këtu sepse ju ishit të frikësuar në vendin tuaj të origjinës, ne këtë e quajmë 'të kërkos azil'. Azili është një vend që ofron mbrojtje dhe siguri.**

Kur ju bëni një kërkesë formale tek autoritetet për të kërkuar azil, ligji e quan këtë 'aplikim ose kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare'. Personi që kërkon mbrojtje është një 'aplikant'. Shpesh ju do të dëgjoni persona që ju quajnë ju një 'azil kërkuar'.


Prindërit duhet të jenë me ju, por nëse ata nuk janë ose ju jeni ndarë nga ata gjatë rrugës, ju jeni një 'i mitur' i pashoqëruar'.

Në këtë rast, ne do t'ju pajisim ju me një 'përfaqësues', i cili është një i rritur që do t'ju ndihmojë juve gjatë kësaj procedure. Ajo ose ai do t'ju ndihmojnë ju me aplikimin dhe mund t'ju shoqërojnë juve kur do ju duhet të flisni me autoritetet. Ju mund të flisni rreth problemeve dhe frikërave tuaja me përfaqësuesin tuaj. Përfaqësuesi juaj është për të siguruar se merret në konsideratë interesi juaj më i mirë, që do të thotë se nevojat, siguria dhe mirëqenia juaj, zhvillimi social dhe pikëmapjet tuaja janë marrë parasysh. Përfaqësuesi juaj gjithashtu mban parasysh mundësitë për bashkimin e familjes tuaj

**Kjo fletë-palosje është vetëm për qëllim informimi. Synimi i saj është që t'ju ofrojë aplikantëve për mbrojtje ndërkombëtare informacionin e duhur përpara se të përkohet procedura e Dublinit. Ajo nuk krijon/ngre të drejta ose detyrime ligjore. Të drejtat dhe detyrimet e Shteteve dhe personave sipas procedurës së Dublinit janë përcaktuar në Rregulloren e (BE) 604/2013.**

©Bashkimi Europian 2014

**Autorizohet riprodhimi. Për çdo përdorim ose ri-prodhim të fotove individuale leja duhet kërkuar direkt nga mbajtësit e të drejtës së autorit.**



*Vendet e Dublinit përfshijnë 28 vende të Bashkimit European (Austrinë (AT), Belgjikën (BE), Bullgarinë (BG), Kroacinë (HR), Qipron (CY), Republikën Çeke (CZ), Danimarkën (DK), Estoninë (EE), Finlandën (FI), Francën (FR), Gjermaninë (DE), Greqinë (EL), Hungarinë (HU), Irlandën (IE), Italinë (IT), Letoninë (LV), Lituaninë (LT), Luksemburgun (LX), Maltën (MT), Hollandën (NL), Poloninë (PL), Portugalinë (PT), Rumaninë (RO), Sllovakinë (SK), Slloveninë (SI), Spanjën (ES), Suedinë (SE), Mbretërinë e Bashkuar (UK)) si dhe 4 vendet që i “asociohen” Rregullit të Dublinit (Norvegjia (NO), Islanda (IS), Zvicra (CH) dhe Litenshtejni (LI)).*



## **NËSE KA DIÇKA QË JU NUK E KUPTONI, PYESNI PËRFAQËSUESIN TUAJ OSE AUTORITETET QË TË MUND T'JU NDIHMOJNË!**

Edhe pse ju kërkua azil në këtë vend, mund të ndodhë që një vend tjetër të shqyrtojë kërkesën tuaj për mbrojtje.

Vetëm një vend mund të jetë përgjegjës për konsiderimin e kërkesës tuaj për mbrojtje. Kjo është e përcaktuar në një ligj që quhet **'Rregulli i Dublinit'**. Ky ligj na kërkon neve të vendosim nëse ne jemi përgjegjës për shqyrtimin e aplikimit tuaj ose nëse një vend tjetër është përgjegjës – ne këtë e quajmë 'procedura e Dublinit'.

Ky ligj aplikohet në një rajon gjeografik që përfshin 32 vende<sup>1)</sup>. Për qëllimin e kësaj fletë-palosje, ne i quajmë këto 32 vende si 'Vendet e Dublinit'.

Mos u largoni nga autoritetet ose në një vend tjetër të Dublinit. Disa njerëz mund t'ju thone se kjo është gjëja më e mirë që ju mund të bëni. Nëse dikush ju thotë që të largoheni, ose që ju duhet të largoheni me ta, tregojini përfaqësuesit tuaj, ose autoriteteve shtetërore menjëherë.

Ju lutemi t'ju tregoni autoriteteve shtetërore sa më shpejt që të jetë e mundur nëse:

- *Ju jeni vetëm dhe ju mendoni se nëna, babai, vëllai ose motra, tezza/halla<sup>2)</sup>, daja/xhaxhai<sup>3)</sup>, gjyshja ose gjyshi mund të jenë prezent në një nga 32 vendet e tjera të Dublinit në hartën në faqen fq. 3;*
- *Nëse është kështu, a dëshironi ju apo jo të jetoni me ta;*
- *Ju udhëtuar për në këtë vend me dikë tjetër, dhe nëse po, me kë;*
- *Ju keni qenë tashmë në një vend tjetër nga 32 'Vendet e Dublinit' të listuara;*
- *Shenjat tuaja të gishtave janë marrë në një vend tjetër të Dublinit: shenjat e gishtave janë imazhe të marra nga gishtat tuaj që ndihmojnë për t'ju identifikuar juve;*
- *Ju keni aplikuar tashmë për azil në një vend të ndryshëm të Dublinit.*

## **ËSHTË SHUMË E RËNDËSISHME QË JU TË BASHKËPUNONI ME AUTORITETET SHTETËRORE DHE QË JU GJITHMONË T'U TREGONI ATYRE TË VËRTETËN.**

Sistemi i Dublinit mjudt t'ju ndihmojë nëse ju jeni i pashoqëruar nga një prind kur ju aplikoni për mbrojtje.

Nëse ne kemi informacion të mjaftueshëm për ta, ne do të kërkojmë për prinderit dhe të afërmit tuaj në vendet e Dublinit. Nëse ne ja dalim t'i gjejmë ata, ne do përpiqemi t'ju mbledhim të gjithëve në vendin ku prindërit ose të afërmit tuaj janë prezentë. Ai vend do të jetë përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës tuaj për mbrojtje.

- 
- 1) **Në faqen 3 gjendet një hartë e këtij rajoni.**
  - 2) **Motra e nënës ose motra e babait tuaj**
  - 3) **Vëllai i nënës ose vëllai i babait tua**

Nëse ju jeni vetëm dhe nuk keni familje ose të afërm në një vend tjetër të Dublinit, ka shumë të ngjarë që aplikimi juaj të shqyrtohet në këtë vend.

Ne gjithashtu mund të zgjedhim të shqyrtojmë aplikimin tuaj në këtë vend, edhe nëse sipas ligjit një vend tjetër mund të jetë përgjegjës. Ne mund t'a bëjmë këtë për arsye humanitare, familjare ose kulturore.

Gjatë kësaj procedure, **ne gjithmonë do të veprojmë në interesin tuaj më të mirë**, dhe ne nuk do t'ju çojmë në një vend ku është gjetur se të drejtat tuaja humane mund të shkelen.

Çfarë do të thotë që ne gjithmonë duhet të veprojmë në interesin tuaj më të mirë? Do të thotë se ne duhet të:

- kontrollojmë kur është e mundur që t'ju bashkojmë juve dhe familjen tuaj në të njëjtin vend;
- sigurojmë se ju do të jeni të sigurtë dhe të qetë, veçanërisht nga njerëz që mund të duan t'ju trajtojnë ju keq/t'ju bëjnë dëm;
- sigurojmë që ju të rriteni i sigurtë dhe në mënyrë të shëndetshme, dhe se ju keni ushqim dhe strehë dhe se nevojat tuaja për zhvillimi social janë plotësuar;
- marrim parasysh pikëpamjet tuaja – për shembull, nëse ju dëshironi të qëndroni me një të afërm ose do të preferonit të mos qëndronit.



## Mosha juaj

Personat mbi 18 vjeç janë “të rritur”. Ata trajtohen ndryshe nga fëmijët dhe adoleshentët (“të miturit”).

Ju lutemi të tregoni të vërtetën për moshën tuaj.

Nëse ju keni ndonjë dokument me vete që tregon moshën tuaj, tregojuni këtë autoriteteve. Nëse autoritetet vënë në pikëpyetje moshën tuaj, është e mundur që një doktor të kërkojë t’ju ekzaminojë juve për të parë nëse ju jeni më pak ose më shumë se 18 vjeç. Ju dhe/ose përfaqësuesi juaj duhet të bini dakort me këtë para se ekzaminimi mjekësor të ndodhë.

NË RRESHTAT E MËPOSHTËM NE DO TË PËRPIQEMI T'JU PËRGJIGJEMI PYETJEVE TUAJA MË TË SHPESHTA QË MUND TË KENI RRETH PROCEDURËS SË DUBLINIT, SI MUND T'JU NDIHMOJË AJO JUVE DHE ÇFARË DUHET TË PRISNI QË TË NDODHË:

## Shenjat e gishtave – Çfarë janë ato? Pse merren ato?

Kur ju kërkoni azil, nëse ju jeni 14 vjeç ose më shumë, një foto ose imazh i gishtave tuaja (të quajtura “shenjë gishti”) do të merren dhe transmetohen në një bazë të dhënash për shenjat e gishtave të quajtur “Eurodac”. Ju duhet të bashkëpunoni me këtë procedurë – të gjithë personat që aplikojnë për azil janë të detyruar nga ligji të japin shenjat e tyre të gishtave.

Shenjat tuaja të gishtave do të kontrollohen në një moment për të parë nëse ju keni aplikuar për azil më parë ose nëse juve ju janë marrë shenjat e gishtave më parë në kufi. Nëse zbulohet se ju keni aplikuar më parë për azil në një vend tjetër të Dublinit, ju mund të dërgoheni në atë vend nëse është në interesin tuaj më të mirë që të shkoni aty. Ky vend pastaj do të jetë përgjegjës për shqyrtimin e aplikimit tuaj për mbrojtje ndërkombëtare.

Shenjat tuaja të gishtave do të ruhen për 10 vjet. Pas 10 vjetësh ato do të fshihen automatikisht nga baza e të dhënave. Nëse ju jeni i suksesshëm me kërkesën tuaj për mbrojtje, shenjat tuaja të gishtave do të rrinë në bazën e të dhënave deri sa ato të fshihen automatikisht. Nëse më vonë ju bëheni qytetar i një vendi të Dublinit, shenjat tuaja të gishtave do të fshihen. Vetëm shenjat tuaja të gishtave dhe gjinia juaj do të ruhen në Eurodac – Emri juaj, fotografia, data e lindjes dhe kombësia nuk dërgohen në bazën e të dhënave ose të ruhen. Megjithatë këto detaje mund të ruhen në bazën tonë kombëtare të të dhënave. Të dhënat e ruajtura në Eurodac nuk do të ndahen me asnjë vend ose organizatë jashtë Vendeve të Dublinit.

Që nga 20 Korriku i 2015, shenjat tuaja të gishtave mund të kërkohen nga autoritetet si policia dhe zyra Europiane e policisë (Europol), të cilat mund t’i kërkojnë shenjat tuaja të gishtave dhe të kenë të drejtë hyrjeje në bazën e të dhënave Eurodac me qëllim parandalimin, zbulimin dhe hetimin e krimeve të rënda dhe terrorizmit.







## Çfarë informacioni duhet që ju të siguroheni që autoritetet shtetërore të dinë rreth situatës tuaj?

Ka të ngjarë që ju të intervistoheni me qëllim që të përcaktohet se cili vend është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës tuaj për azil. Në këtë intervistë, autoritetet tona shtetërore do ju spjegojnë juve ‘procedurën e Dublinit’ dhe do të përpiqen të gjejnë, nëse është e mundur, që të ri-bashkoheni me familjen tuaj në një vend tjetër të Dublinit.

Nëse ju e dini se prindërit tuaj, vëllezrit dhe motrat, ose një i afërm janë në një vend tjetër të Dublinit, ju lutemi të mos harroni t’ja përmendni këtë personit që do t’ju intervistojë. Ofroni sa më shumë informacion që të jetë e mundur për të na ndihmuar të gjejmë familjen tuaj – emra, adresa, numra telefoni, etj.

Gjatë intervistës, ju mund të pyeteni nëse keni qenë më parë në ndonjë vend tjetër të Dublinit. Ju lutemi të tregoni të vërtetën.

Përfaqësuesi juaj mund t'ju shoqërojë juve në intervistë, për t'ju dhënë ndihmë dhe mbështetje dhe të bëjë çfarë është më e mira për ju. Nëse keni arsye që nuk e doni përfaqësuesin tuaj të jetë aty me ju, ju duhet t'u tregoni autoriteteve shtetërore.

**NË FILLIM TË INTERVISTËS, INTERVISTUESI DHE PËRFAQËSUESI JUAJ DO T'JU SPJEGOJNË PROCEDURAT DHE TË DREJTAT TUAJA. NËSE KA DIÇKA QË JU NUK E KUPTONI, OSE KENI PYETJE TË TJERA, JU LUTEMI T'I PYESNI ATA!**

Intervista është e drejta juaj dhe është pjesë e rëndësishme e aplikimit tuaj.

Intervista do të realizohet në një gjuhë që ju e kuptoni. Nëse ju nuk jeni në gjendje të kuptoni gjuhën që përdoret, ju mund të kërkonti një përkthyes që t'ju ndihmojë të komunikoni. Përkthyesi duhet të përkthejë vetëm atë që ju dhe intervistuesi thoni. Përkthyesi nuk mund të shtojë pikëpamjet e tij/saj personale. Nëse keni vështirësi për të kuptuar përkthyesin, ju duhet të na tregoni dhe/ose të flisni me përfaqësuesin tuaj.

Intervista do të jetë konfidenciale. Kjo do të thotë se asnjë informacion që ju jepni, përfshirë faktin që ju keni aplikuar për mbrojtje në vendin tonë, nuk do të dërgohet tek personat dhe ose autoritetet të cilët mund t'ju dëmtojnë ju në ndonjë mënyrë ose të dëmtojnë ndonjë anëtar të familjes tuaj ende në vendin tuaj të origjinës.

**ËSHTË E RËNDËSISHMË QË JU DHE PËRFAQËSUESI JUAJ TË JENI NË DIJENI TË KOHËZGJATJES SË PROCEDURËS SË DUBLINIT!**

## Sa hohë duhet para se ju të merrni vesh nëse ju duhet të shkoni në një vend tjetër apo të qëndroni këtu?

### Çfarë ndodh nëse një vend tjetër gjendet përgjegjës për shqyrtimin e aplikimit tuaj?

→ Nëse ky është aplikimi juaj i parë për azil në një vend të Dublinit, ju do të dërgoheni në një vend tjetër sepse nëna juaj, babai, vëllai, motra, tezja/halla, xhaxhai/daja, gjyshi ose gjyshja janë prezentë në atë vend dhe ju do t'ju bashkoheni asaj/atyre atje dhe të rri bashkë për shqyrtimin e aplikimit tuaj për azil<sup>4)</sup>.

→ Nëse ju nuk keni aplikuar për azil këtu, por keni aplikuar për azil në një tjetër vend të Dublinit në të kaluarën, ju mund të dërgoheni në atë vend me qëllim që autoritetet aty të konsiderojnë aplikimin tuaj për azil<sup>5)</sup>.

**Në të dy rastet mund të duhet deri në pesë muaj për të marrë një vendim për t'ju transferuar ju në një vend tjetër, si nga momenti që ju kërkuat azil ose nga momenti që ne morëm vesh se ju kishit aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare në një vend tjetër të Dublinit. Autoritetet do t'ju informojnë ju sa më shpejt që të jetë e mundur pasi vendimi të jetë marrë.**

→ Nëse nuk kërkuat azil në këtë vend dhe aplikimi juaj i mëparshëm për azil në një vend tjetër u mohua pas shqyrtimit të plotë, ne ose do t'i kërkojmë vendit tjetër t'ju marrë ju mbrapsht ose do të vazhdojmë me kthimin tuaj në vendin e origjinës ose banesën e përhershme ose në një vend të tretë të sigurtë.

Nëse ne vendosim se një tjetër vend është përgjegjës për aplikimin tuaj për azil, kur vendi që i kërkohet të marrë përgjegjësi për ju pranon t'a bëjë këtë, ju do të informoheni zyrtarisht që ne nuk do t'a shqyrtojmë kërkesën tuja për mbrojtje ndërkombëtare, dhe ne do t'ju transferojmë ju në vendin përgjegjës.

---

4) **Ju mund të dëgjoni njerëz që kësaj i referohen si 'merr në përgjegjësi'.**

5) **Ju mund të dëgjoni njerëz që kësaj i referohen si 'merr mbrapsht'.**

Transferimi juaj do të ndodhë brenda gjashtë muajve nga momenti që vendi tjetër pranon përgjegjësi për ju, ose vendimi final për apelimin ose rishikimin, nëse ju nuk bini dakord dhe vendosni t'a kundërshtoni këtë vendim (shih seksionin më poshtë që shpjegon se çfarë do të thotë kjo!). Ky limit kohor mund të shtyhet deri në një vit nëse ju burgoseni, ose deri në 18 muaj nëse ju fshiheni ose ikni.



## Çfarë ndodh nëse ju nuk doni të shkoni në një vend tjetër?

### FLISNI ME PËRFAQËSUESIN TUAJ RRETH KËSAJ!

Nëse ne vendosim se ju duhet të shkoni në një vend tjetër dhe aplikimi juaj të shqyrtohet atje, dhe ju nuk bini dakord me këtë, ju keni mundësinë t'a kundërshtoni vendimin e transferimit. Ne këtë e quajmë 'apelim' ose 'rishikim'.

Kur merrni nga autoritetet zyrtare vendimin për transferim, keni 21 ditë kohë për të kërkuar ndryshim të vendimit në gjykatën administrative. Është shumë e rëndësishme që ju t'a dërgoni apelin brenda këtij kuadri kohor. Përfaqësuesi juaj duhet t'ju ndihmojë juve me këtë.

- Keni 7 (shtatë) ditë kohë të kërkonit pezullim të transferimit, deri sa të shqyrtohet kërkesa juaj për ndryshim vendimi. Një gjykatë ose tribunal do të vendosë shpejt për këtë kërkesë. Nëse pezullimi juaj mohohet juve do t'ju jepet një arsye për këtë.
- Në fund të kësaj fletë-palosje gjendet informacion se cilin autoritet të kontaktoni me qëllim që të apelonit një vendim në këtë vend.

Gjatë procedurës së 'apelimit' ju do të keni të drejtë për asistencë ligjore, dhe nëse është e nevojshme, asistencë gjuhësore nga një përkthyes. Ju mund të kërkonit të merrni asistencë ligjore falas nëse nuk keni para për të. Fundi i kësaj fletë-palosje përmban detajet e kontaktit për organizatat që ofrojnë asistencë ligjore dhe që mund t'ju ndihmojnë me apelin tuaj

## Ndalimi

Personat që nuk janë të lirë të udhëtojnë aty ku duan strehohen në një ndërtesë të mbyllur ku ata nuk ikin dhe u thuhet që janë në “ndalim”.

Nëse ju jeni i mitur i pashoqëruar, ju mund të jetoni një një ambient ku ka rregulla që ju duhet të qendroni brenda natën ose kur erret ose rregulla që ju duhet t’u tregoni personave që kujdesen për ju nëse ju po dilni jashtë dhe se kur do të ktheheni. Këto rregulla janë për të mbrojtur sigurinë tuaj. Kjo nuk do të thotë se ju jeni në një vend ndalimi.

### FËMIJËT POTHUAJSE KURRË NUK NDALOHEN!

**A jeni ju në ndalim? Nëse ju nuk jeni i sigurtë nëse jeni të ndaluar, lutemi pyesni autoritetet, përfaqësuesin tuaj ose këshilluesin ligjor<sup>6)</sup> sa më shpejt që të jetë e mundur. Ju pastaj mund të flisni me ta rreth situatës tuaj dhe nëse jeni në ndalim, rreth mundësisë për të kundërshtuar vendimin e ndalimit!**

Ka rrezik që ju t’a gjeni veten në ndalim gjatë procedurës së Dublinit. Shumicën e kohës kjo ndodh kur autoritetet nuk besojnë se ju jeni nën 18 vjeç dhe kanë frikë se ju mund të largoheni ose fshiheni nga ata sepse keni frikë se mund të dërgoheni në një vend tjetër.

Ju keni të drejtë të informoheni me shkrim për arsyen se pse jeni ndaluar, dhe se si të kundërshtoni urdhërin e ndalimit. Ju keni gjithashtu të drejtë për asistencë ligjore nëse dëshironi të kundërshtoni urdhërin e ndalimi, kështu që flisni me përfaqësuesin tuaj ose këshilluesin ligjor nëse jeni të pakënaqur.

Nëse ju ndaloheni gjatë procedurës së Dublinit, kuadri kohor i procedurës për ju do të jetë si më poshtë: ne do na duhet t’i kërkojmë një vendi tjetër të marrë

---

6) **Një person që njihet nga autoritetet si përfaqësues i interesave tuaja para ligjit. Përfaqësuesi juaj dhe/ose autoritetet duhet t’ju këshillojnë juve nëse ju keni nevojë për një të tillë, por ju mund t’ju kërkoni atyre që t’ju prezantojnë me një përfaqësues në emrin tuaj. Shihni fundin e kësaj fletë-palosje për organizata që ju mund t’ju ofrojnë juve përfaqësim ligjor.**

përgjegjësi për ju brenda **një muaji** nga dorëzimi i aplikimit tuaj për azil. Vendi që i kërkohet duhet të japë përgjigje brenda **dy javësh** pas kësaj. Së fundi, nëse ju jeni ende në ndalim, transferimi juaj duhet të realizohet brenda **gjashtë javësh** nga pranimi i kërkesës nga vendi përgjegjës.

Nëse ju vendosni të kundërshtoni vendimin e transferimit ndërsa jeni në ndalim, autoritetet shtetërore nuk kanë detyrim për t'ju transferuar juve brenda gjashtë javëve. Pastaj autoritetet shtetërore do t'ju njoftojnë juve rreth opsioneve tuaja.

Nëse autoritetet shtetërore nuk respektojnë kuadrin kohor për të pyetur një vend tjetër të marrë përgjegjësi për ju, ose nuk e realizojnë në kohë transferimin tuaj, ndalimi juaj për qëllimin e transferimit sipas Rregullit të Dublinit do të përfundojë. Në atë rast, do të aplikohen limitet normale kohore në prezantuar në faqen 11.





## Cilat janë të drejtat tuaja gjatë periudhës që ne vendosim cili është përgjegjës për ju?

Ju keni të drejtë të qëndroni në këtë vend, nëse ne jemi përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës tuaj për azil, ose, nëse një tjetër vend është përgjegjës, derisa ju të transferoheni atje. Nëse vendi ku ju jeni prezent aktualisht është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës tuaj për azil, ju keni të drejtë të qëndroni aty të paktën deri në sa të merret një vendim i parë për aplikimin tuaj për azil. Ju gjithashtu keni të drejtë të përfitonit nga kushtet materiale të pritjes, p.sh. akomodimi, ushqimi, etj., se dhe kujdesi mjekësor bazë dhe asistenca mjekësore urgjente. Ju gjithashtu keni të drejtë të shkoni në shkollë.

Juve do ju jepet mundësia të na jepni informacion rreth situatës tuaj dhe prezencës së anëtarëve të familjes në territorin e vendeve të Dublinit me gojë dhe/ose shkrim, dhe kur t'a bëni këtë, të përdorni gjuhën e nënës ose një gjuhë që ju e flisni mirë (ose të keni një përkthyes, nëse nevojitet). Ju gjithashtu do të merrni një kopje të shkruar të vendimit për t'ju transferuar në një vend tjetër. Ju keni gjithashtu të drejtë të na kontaktoni neve për më shumë informacion dhe/ose të kontaktoni zyrën e Kombeve të Bashkuara të Komisionerit të Lartë për Refugjatët (UNHCR) në këtë vend.

**Përfaqësuesi juaj dhe autoritetet shtetërore do t'ju shpjegojnë më shumë rreth të drejtave tuaja!**



## **Çfarë do të ndodhë me informacionin personal që ju dhatë? Nga ta dini ju se nuk do të përdoret për qëllime të këqija?**

Autoritetet e vendeve të Dublinit mund të shkëmbejnë informacionin që ju u jepni atyre gjatë procedurës së Dublinit, vetëm për të plotësuar detyrimet sipas Rregullit të Dublinit.

Ju keni të drejtë të dini:

- Informacionin që lidhet me ju. Ju keni të drejtë të kërkonti që këto të dhëna të ndryshohen nëse nuk janë të sakta ose të vërteta, ose të shuhen nëse janë marrë/trajtuar në mënyrë të paligjshme;
- Informacionin që spjegon se si të kërkuar që të dhënat tuaja të korrigjohen ose fshihen, përfshirë detajet specifike të kontaktit të autoriteteve kompetente që identifikohen si përgjegjës për procedurën tuaj të Dublinit, dhe të autoritetit kombëtar për mbrojtjen e të dhënave për të dëgjuar Kërkesën në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale

## KU MUND TË DREJTOHENI PËR NDIHMË?

### **Adresa dhe informacionet e kontaktit të autoritetit zyrtar për azilkërkim**

Maahanmuuttovirasto (Zyra e Migracionit)

PL 18, 00581 Helsinki

+ 358 295 419 600

Numri i shërbimit në këtë lëndë:

+ 358 295 419 627,

E martë–E enjte ora 10–11

[www.migri.fi](http://www.migri.fi)

### **Përfaqësuesi i të miturit**

Gjykata komunale vendos një përfaqësues për azilkërkuesin e mitur dhe të pashoqëruar. Qendra e pranimit të refugjatëve i bën kërkesë gjykatës komunale për caktimin e një përfaqësuesi.

### **Mbrojtja e fëmijëve**

Qendra e pranimit të refugjatëve ka për detyrë të organizojë për fëmijën shërbimet sociale, të cilat vlerësohen si të nevojshme nga punëtori përgjegjës social për fëmijën nga pikëpamja e shëndetit dhe zhvillimin e fëmijës. Kontaktoni punëtorin e socialit të qendrës tuaj të pranimit lidhur me pyetje mbi këtë çështje.

### **Autoriteti përgjegjës për procesin e Dublinit**

Maahanmuuttovirasto (Zyra e Migracionit)

Kontaktet më lart.

### **Informacionet e kontaktit të autoritetit zyrtar për ruajtjen e të dhënave personale**

Tietosuoja-valtuutetun toimisto (Zyra e ombudsmanit për ruajtjen e të dhënave personale)

PL 800, 00521 Helsinki

+ 358 295 666 700

Këshilla me telefon:

+358 295 616 670,

E hënë–e enjte ora 9–11 dhe

ora 13–15, e premte ora 9–12

[tietosuoja@om.fi](mailto:tietosuoja@om.fi)

[www.tietosuoja.fi](http://www.tietosuoja.fi)

### **Mbajtësi i sistemit Eurodac dhe përfaqësuesi i tij**

Pikat e kontaktit: Administrata e policisë (Poliisihallitus) dhe Zyra e Migracionit (Maahanmuuttovirasto)

### **Informacionet e kontaktit të mbajtësit të regjistrit**

+ 358 295 480 181

Administrata e policisë (Poliisihallitus)

PL 22, 00521 Helsinki

[kirjaamo.poliisihallitus@poliisi.fi](mailto:kirjaamo.poliisihallitus@poliisi.fi)

Maahanmuuttovirasto (Zyra e Migracionit)  
PL 18, 00581 Helsinki  
+358 295 419 600  
Numri i shërbimit në këtë lëndë:  
+358 295 419 627,  
e martë–e enjte ora 10–11  
[www.migri.fi](http://www.migri.fi)

Nëse dëshironi të njiheni me informacionet tuaja të regjistruara në sistemin Eurodac, atëhere bëni një lutje personalisht në polici. Përgatituni të dëshmoni identitetin tuaj. Rekomandojmë që të kontaktoni me atë stacion policie që pranoi edhe kërkesën tuaj për azilkërkim. Informacionet e kontaktit të policisë gjenden në faqen e internetit, [poliisi.fi](http://poliisi.fi).

### **Kryqi i Kuq i Finlandës**

Suomen Punainen Risti  
Tehtaankatu 1 a  
00140 Helsinki  
+358 20 701 2000  
[info@redcross.fi](mailto:info@redcross.fi)  
[www.redcross.fi](http://www.redcross.fi)

### **Kërkimi për familjarët e humbur.**

#### **Zyrat e ndihmës ligjore dhe organizatat për refugjatë**

Ndihma ligjore ofrohet nga zyra të ndihmës ligjore dhe zyra avokatie e juristë, të cilët e kanë njof-tuar qendrën e pranimit të refugjatëve për

shërbimet ligjore që ata ofrojnë lidhur me azilkërkuesit. Për informacione të mëtejshme mbi ndihmësit ligjore mund të pyesni punonjësit e qendrës së pranimit të refugjatëve.

### **Informacionet e kontaktit të Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM)**

IOM Helsinki  
Unioninkatu 13, kati 6  
PL 851, 00101 Helsinki  
+358 9 684 1150  
[iomhelsinkiivr@iom.int](mailto:iomhelsinkiivr@iom.int)  
[www.iom.fi](http://www.iom.fi)

Nëse dëshironi të ktheheni vullnetarisht në atdheun tuaj, atëhere informohuni te qendra e pranimit.

### **Zyra rajonale më e afërt e Komisionerit të Lartë të OKB-së për Refugjatët**

UNHCR  
Ynglingagatan 14, 6 tr  
113 47 Stockholm  
Sverige  
tel. +46 8 457 48 80  
[swest@unhcr.org](mailto:swest@unhcr.org)



Rajavartiolaitos  
Gränsbevakningsväsendet  
The Finnish Border Guard